VENDIM
Nr. 138, datë 6.9.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "AFRIMI K" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "THANZË" ME FUQI TË INSTALUAR 2 MW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1, germa "a"; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Afrimi K" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Afrimi K" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa "b" nuk është plotësuar. Germat "a", "c", "d", "f" dhe "g", plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "b" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3 dhe 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 9, pika 2, germa "b", do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", neni 11, pika 1, t'i paraqesë ato në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Afrimi K" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë nga HEC "Thanzë" me fuqi të instaluar 2 mw.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti